



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Nr.01-060/01-10101/23 datë:24.04.2023



Npi – 01/184 datë:28.04.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shitmes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e mbajtur më: 28.04.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S Ë -IV- T Ë K O M I T E T I T P Ë R S H Ë N D E T Ë S I D H E M I R Ë Q E N I E S O C I A L E
E mbajtur më datën: 28.04.2023 (e premte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesja: znj.Besartë Musliu-Spahija, Anëtarët: z.Hasan Avdyli, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota dhe znj.Arbresha Sylja. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe drejtori i DSHMS-së, z.Isa Haxhiu. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit znj.Besarta Musliu-Spahija, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2023,
2. Informat nga DSHMS- per ditën Boterore per Autizmin,
3. Informat nga Drejtoria e Shendetesis per Diten Boterore te siguris dhe Shendetit Mendor,
4. Diskutim rreth gjendjes ne komunën tone ne lidhje me drogën,
5. Të ndryshme.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje, e kuptoj që Sekretaria është e ngarkuar me punë, dhe për këtë arsye unë po kërkoj që ta bëjmë një Rekomandim për Kryetarin, Kryesuesin dhe Zyrën e Personelit, që ta pranojnë edhe një zyrtarë për Kuvendin, që ta bëjnë zgjidhjen e përhershme. Pajtoj me rendin e ditës

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2023

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2023.**

Pika 2

Informat nga DSHMS- per ditën Boterore per Autizmin

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Fjalën ja dha Isa Haxhiut drejtor i DSHMS-së.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, lexoi Informatën në tërësi, në fund pasi lexoi tha nëse ka dikush ndonjë pyetje unë do të përgjigjem (shih dokumentin).

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Faleminderit për Informatën, hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për Informatën, për sa i përket Autizmit ne nuk kemi shumë informata, por pyetja ime është se a u dalim në ndihmë mjaftueshëm kësaj kategorie.

znj.Arbresha Sylja; Përshëndetje, Psikoterapia është tani më një degë e re, e di që në Maqedoni ka klinika private për trajtim. Ndërsa sa i përket Kosovës trajtimi bëhet kryesisht në klinikat private. Me sa e di unë nuk marrin kjo kategori ndonjë ndihmë të veçantë. Për ta ende nuk ka diagnostikë të veçantë por trajtohen në kuadër të psikologut klinik. Psikoterapitë trupore janë për secilin rast specifik. Kjo nuk konsiderohet si sëmundje, por si persona më të veçantë. Mendoj se nevojitet për me e sensibilizuar opinionin për me i paraqit për trajtim rastet dhe mos me ngurru.

Pika 3

Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë për Ditën Botërore të sigurisë dhe Shëndetit Mendor

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Fjalën ja dha Isa Haxhiut drejtor i DSHMS-së.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; 28 Prilli njihet si dita për aksidentet në punë. Informatën pra e keni të shkruar dhe e keni pranuar me kohë, unë do ta lexoj pjesën ku bëhet fjalë për këtë pikë. (Shih dokumentin), nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Reshat Mujota; A dihen të drejtat e punëtorëve, dhe si është çështja me Sindikatën?

znj.Arbresha Sylja; A ka sigurim QKMF-ja?

z.Reshat Mujota; Pyetja është edhe se a ka pas sigurim edhe përpara QKMF-ja?

znj.Arbresha Sylja; Unë nuk jam duke i amnestuar as ata përpara e as këta tash.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Unë personalisht kam pas problem si paciente në QKMF-ë Shtime.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Ne as në Komunë nuk kemi sigurim.

Pika 4

Diskutim rreth gjendjes në komunën tone në lidhje me drogat

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Fjalën ja dha Isa Haxhiut drejtor i DSHMS-së.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Në vitin 2022 kemi pas 8 raste, me 18 persona të përfshirë. Moshë e tyre sillet nga 20 deri në 40 vjeç.

z.Hasan Avdyli; Përshëndetje, mendoj se kjo është një çështje e ndjeshme, dhe po ashtu mendoj se është një neglizhencë e jona karshi kësaj dukurie të keqe. Unë jam i bindur se me një angazhim më të madh duke filluar nga familja dhe Institucionet do ta kishim një gjendje shumë më të mirë. Duhet pra shumë më seriozisht të merret kjo çështje nga familja, shkolla dhe institucioni, dhe kështu mendoj se do të kishim ose më pak ose nuk do të kishim fare raste që merren ose që konsumojnë lëndë të dëmshme narkotike, sidomos sa i përket të rinjëve. Në QPS-ë mungon punëtori social që merret me trajtimin e kësaj kategorie. Duhet shumë të punohet edhe në parandalimin e këtyre rasteve. Meqenëse unë kam punuar aty, ne më parë jemi munduar me i trajtuar këto raste sipas mundësive që kemi pasur, por tani ka edhe mungesë të stafit në QPS-ë. Nuk e di pse është neglizhuar mospranimi i punëtorëve në QPS-ë. Unë dua të bëj thirrje për të gjithë që ti fuqizojmë Institucionet dhe që të sensibilizojmë qytetarët e komunës tonë, lidhur me këtë dukuri negative, po ashtu të punojmë në edukimin e familjeve që është shumë e rëndësishme për parandalimin e përdorimit dhe trafikimit të mjeteve narkotike.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Sa i përket mungesës së stafit në QPS-ë, gjendja është vështirësuar për arsye se ju z.Hasan keni shkuar në pension së bashku edhe me Latën. Ne kemi

shpallur konkurs për këtë, janë pranuar kandidatët por pastaj konkursi është kthyer në pikën zero. Prapë është shpallur konkursi dhe komisioni i ka pranuar kandidatët, por ndoshta për shkak të ndonjë ankese ende nuk është filluar me punën. Pajtohem se kemi mungesë sidomos të stafit profesional në QPS-ë, ku mendoj se është e domosdoshme me pas një psikolog klinik.

z.Reshat Mujota; E thatë ju drejtor se kemi 8 raste me 18 persona të përfshirë, pyetja ime është a janë këta diler apo konsumues?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Mendoj se aty janë edhe diler por edhe konsumues, sepse nuk i kemi informatat të ndara në detaje, mirëpo shqetësues është fakti i përfshirjes së shkollave si të rinjtë.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.


z.Reshat Mujota; Unë e thash qysh në fillim se Sekretaria e Kuvendit duhet të kompletohet edhe me një zyrtarë, kështu pra kërkesa ime është që ti rekomandojmë Kryetarit, Kryesuesit dhe Zyrës së Personelit që të rritet numri i zyrtarëve në Sektorin e Kuvendit, me arsyetimin që mos me na ardhur materiali me vonesë, siç është rasti sot me Procesverbalin. Ne po kërkojmë që me u kryer shkrimet më mirë dhe më shpejt. Prandaj kërkoj nga Kryesuesja që ta qet në votim propozimin tim.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Konstatoi Kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e -IV- të mbajtur më 28.03.2023, unanimisht vendosi që t'i Rekomandoi, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit dhe Shefit të Zyrës së Personelit, që sa më parë të kompletohet Zyra e Kuvendit edhe me një Zyrtar/e për sektorin e Kuvendit dhe Komiteteve.**

Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 11:16h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Besartë Musliu-Spahija

